

## **PROCESVERBAL**

**Mbledhja 23.06.2023**

Sot me datë **23.06.2023**, ora **10:00**, në sallën mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, u mbajt mbledhja jashtë radhe e Këshillit Bashkiak Kukës, në zbatim të ligjit 139/2015.” Për Vetëqeverisjen vendore “, Rregulloren e funksionimit dhe organizimin të Këshillit Bashkiak si dhe njoftimin përkatës.

Në mbledhje morën pjesë : **Gazmend Hallaci, Albert Muja, Republika Tusha, Arjeta Zela, Astrit Dobrush, Xhem Visha, Erjon Brati, Rubin Omuri, Blerona Potja, Adelina Shllaku, Sami Mata, Edmond Hallaçi, Ervis Gjani, Bledar Lleshaj, Valion Muja, Arjan Cengu, Astrit Cengu, Aurora Guska, Bajr Bajra, Musë Kastrati, Gazmend Oruçi, Gëzim Shehu, Armida Rexhaj, Halim Peca, Hume Elezaj, Fasli Gërmizi, Destan Spahiu.**

Pasi thirret prezenca dhe konstatohet se është kuorumi i nevojshëm, Kryetari i Këshillit bashkiak deklaroi hapjen e mbledhjes.

Mbledhja është jo e zakonshme. Kryetari i Bashkisë Kukës është shkarkuar nga detyra. Në këto rrethana të krijuara, ju ftoj që të shohim përpara për të mirën e qytetarëve që na kanë zgjedhur. Meqenëse Bashkia Kukës ka vetëm një zv/kryetar, sipas ligjit ai ngarkohet të kryejë funksionin e kryetarit të Bashkisë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

Vijojmë me rendin e ditës. Kemi parashikuar ngritjen e komisioneve të përhershme.

Merr fjalën Fasli Gërmizi: Mbledhja e konstituimit ka pasur disa parregullsi, si: Fillimisht morën mandatet 31 anëtarë të këshillit dhe pas konstatimit të papajtueshmërisë u vendos që përfundimisht ta marrin mandatin 30 anëtarë, vendimi i gjykatës për vlefshmërinë e mandatit të kryetarit të bashkisë mbante datën 08.06.2023 ndërkohë mbledhja e konstituimit u mbajt me datë 09.06.2023, etj.

Albert Muja: - Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet me 18 vota pro.

Votohet për numrin e anëtarëve të komisioneve dhe miratohet përbërja prej 5 anëtarësh për secilin komision.

Fasli Gërmizi largohet nga mbledhja.

Fillohet me propozimet për anëtarët e komisioneve:

1. Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Ceshtjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, zgjedhjeve dhe Strukturave Komunitare, propozohen dhe miratohen me shumicë votash anëtarët si më poshtë: Aurora Guska, Destan Spahiu, Valion Muja, Ervis Gjana, Halim Peca.
2. Komisioni i Ekonomisë, Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Mbikëqyrjes Financiare, Planifikimit dhe Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, propozohen dhe miratohen këto anëtarë: Sami Mata, Gazmend Oruçi, Bledar Lleshaj, Rubin Omuri, Gazmend Hallaçi, Fasli Gërmizi, Gëzim Shehu.
3. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave, Etikës, Standarteve dhe apeliemeve, propozohen dhe miratohen këta anëtarë: Hume Elezaj, Musë Kastrati, Republika Tusha, Arjeta Zela, Edmond Hallaçi
4. Komisioni i Mirëqenies Sociale, Barazisë Gjinore dhe Rinisë, propozohen dhe miratohen këta anëtarë: Hume Elezaj, Blerona Potja, Teuta Elezaj, Erjon Brati Armida Rexhaj.
5. Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile Infrastrukturës dhe Strehimit, propozohen dhe miratohen këta anëtarë: Astrit Cengu, Ervis Gjana, Bajr Bajra, Xhem Visha, Arjan Cengu
6. Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, propozohen dhe miratohen këta anëtarë: Arif Rexhmati, Halim Peca, Arjeta Zela, Bledar Lleshaj, Astrit Dobrushit.
7. Komisioni i Kulturës, Dhënies së Titujve, Emërtimeve, Arsimit dhe Sportit, propozohen dhe miratohen këta anëtarë: Halim Peca, Fasli Gërmizi, Destan Spahiu, Erjon Brati, Hume Elezaj.

Tet ë ndryshme, propozohet shqyrtimi I projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%. Hidhet në votim dhe miratohet me të gjitha votat pro.

Gjithashtu diskutohet për krijimin e grupimeve politike në këshill si dhe publikimin e emailit dhe nr e telefonit të anëtarëve për komunikimet zyrtare. Këshilltarët do të japin adresat personale të emailit për komunikimet zyrtare ( njoftimet për mbledhe e takime, materialet për shqyrtim, kërkesa dhe ankesa të qytetarëve, etj). Mbyllet mbledhja,

**Kukës 23.06.2023.**